

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAËTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE


KONTRATA

Titulli: Furnizim me pajisje mbrojtëse personale për inspektorët e punës

Nr. i Prokurimit¹ 209-20-5329-1-3-6

Nr i brendshëm 209/20/017/136

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



KONTRATA

MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

"RIMI-ALTEX"SH.P.K., D.E KOMBIT, 70000, FERIZAJ (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizim me pajisje mbrojtëse personale për inspektorët e punës me numër Identifikues **209-20-5329-1-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me pajisje mbrojtëse personale për inspektorët e punës**

Nr.	Përshkrimi I artikullit	Njësia	Sasia
1	Helmeta (ngjyrë të bardhë; me logo të Inspektoriatit të Punës; me standarde ISO dhe CE)	copë	60
2	Këpuca të punës (dimrore nr.38-45)	palë	60
3	Jelekë vezullues (me logo të Inspektoriatit të Punës)	copë	60
4	Shirit sinjalizues (me logo të Inspektoriatit të Punës)	metër	3400

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 22.10.2020 dhe perfundon mbrenda 10 dite nga data e marrjes së urdhëreses

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve do të jetë nga operatori ekonomik për furnizimi me pajisje mbrojtëse personale për inspektorët e punës në të gjithë Kosovën.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: *[4,100.00] €; [katërmijë e njëqind euro e zero cent] Euro.*

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *shërbimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[furnizimeve]*, *[shërbimeve]*, *[punëve]*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha furnizimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *shërbimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtrëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse

nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykata ekonomike e Prishtinës* në pajtim me ligjin e Kosovës.




Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, për menaxhim kontrate është z. Luan Kastri, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	NEHAT GOGA	Emri:	Fa Vllahi
Pozita:	ME NAXHCR	Pozita:	Kryesori Buzdout te prokurorit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	22.10.2020	Data:	22.10.2020
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Numri i Prokurimit: 209-20-5329-1-3-6 numri i brendshëm i prokurimit: 209/20/017/136 – Titulli Furnizim me pajisje mbrojtëse personale për inspektorët e punës

PJESA C: FORMULARI I PARAOITJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Seksioni I. Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Për: MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE (më tej "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i Kontratës: Furnizim me pajisje mbrojtëse personale për inspektorët e punës

Në përgjigje të letrës suaj të ftesës për tender për kontratën e mësipërme, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Ne kemi shqyrtuar dhe pranuar përbajtjen e plotë të dosjes së tenderit Nr 209-20-5329-1-3-6. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësinë e tyre, pa rezervim ose kufizim.

2. Çmimi i përgjithshëm i kuotimit është:

Çmimi i përgjithshëm i kuotimit në shifra: [4.100.00 Euro e]

Dhe me shkrim [Katermi e njëqind euro e zero cent Euro]

3. Ky kuotim është i vlefshëm për një periudhë prej 30 ditë nga data përfundimtare për dorëzimin e kuotimit të çmimeve.

4. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Ne gjithashtu plotësisht të njohim dhe pranojmë se ndonjë informacion të pasaktë ose të paplotë të dhënë me qëllim në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga kjo dhe kontrata të tjera të financuara nga BKK.

5. Çmimi i përgjithshëm i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi gjatë kontratës (duke përjashtuar çmimet e këtyre artikujve që janë subjekt i rregullimeve të çmimeve në bazë të shkëmbimit të aksioneve përkatëse). Çmimi i përgjithshëm i kuotuar specifikohet dhe është i bashkangjitur në Specifikimet e Çmimit.

DORËZUAR NGA:

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	RIMI-ALTEX Shpk
ADRESA E PLOTE	Dëshmoret e Kombit ne 154 Ferizaj 70000
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	Trim Goga
POZITA	Drejtor
NENSHKRIMI	
DATA	28/09/2020
VULA	

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr.	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH.	Totali me TVSH
1	Helmëta (ngjyrë të bardhë; me logo të Inspektoriatit të Punës; me standarde ISO dhe CE)	copë	60	7.00	420.00
2	Këpuca të punës (dimrore nr.38-45)	palë	60	28.00	1,680.00
3	Jelekë vezullues (me logo të Inspektoriatit të Punës)	copë	60	5.00	300.00
4	Shirit sinjalizues (me logo të Inspektoriatit të Punës)	metër	3400	0.50	1,700.00
Totali i përgjithshëm:					4,100.00

Nënshkrimi dhe Vula e OE:

